



RROKUM TV
Migjen KELMENDI
Drejtor
Prishtinë

Ankesa Nr. 2017/15 KPM vs RROKUM TV
Ref:1708/792/KPM/am

VENDIM

**Lidhur me Ankesën nr. 2017/15 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër
RROKUM TV (“Pala Përgjegjëse”)**

Faktet

1. Pala Përgjegjëse është pajisur me Licencë të KPM-së me datën 5 dhjetor 2008. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës obligon të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin e KPM-së dhe me të gjitha aktet nënligjore të miratuara nga KPM.
2. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03 i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
3. KPM me datën 13 mars 2017 ka pranuar një ankesë nga Index Kosova, lidhur me emisionin “Rrokum Rroll” të transmetuar në Rrokum TV me datë 10 shkurt 2017. Në ankesën e Index Kosova theksohet se “gjatë emisionit “Rrokum Roll” të televizionit Rrokum TV janë transmetuar intervista nga të ftuarit me përmbajtje shpifëse dhe fyese ndaj pronarit z. Visar Berisha dhe znj. Vlora Berisha drejtoreshë ekzekutive, si dhe kundrejt klientëve të Index kosova.” Këto intervista janë bazuar në emisionin “Rrokum Rroll” të datës 10 shkurt 2017, të transmetuar në Rrokum TV, ku të ftuar kanë qenë z. Migjen Kelmendi dhe Ardian Lama. Në ankesë gjithashtu theksohet se të thënat e të ftuarve janë të pavërteta dhe përmbanin në vete shpifje dhe fyerje.
4. KPM me datën 14 mars 2017 me anë të një letre sqaruese ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse që të sjellë sqarim lidhur me ankesën në fjalë.
5. Pala Përgjegjëse është përgjigjur me datën 16 mars 2017 duke theksuar se: “Në emisionin “Rrokum Rroll” është argumentuar në mënyrë të bazuar mashtrimi i kryer nga

ana e Index Kosova me anë të një sondazhi për audiencë, i cili qëllimisht paraqet rezultate fiktive duke dëmtuar konkurrencën e ndershme në industrinë e mediave dhe duke dëmtuar biznesin e kompanisë sonë prej disa vitesh dhe gjuha e përdorur gjatë emisionit ka qenë konform parimit të shprehjes së lirë dhe kodit të etikës gazetareske.”

6. KPM me qëllim të vlerësimit të ankesës së Palës ankuese ka bërë monitorimin e emisionit “Rrokum Rroll” të transmetuar me datë 10 shkurt 2017 dhe ka gjetur se në këtë emision është përdorur gjuhë jo e përshtatshme në kontekst fyes dhe akuzues ndaj veprimtarisë së z. Visar Berisha pronar i kompanisë Index Kosova dhe znj. Vlora Berisha drejtoreshë ekzekutive në këtë kompani. KPM bazuar në raportin e monitorimi të datës 22 mars 2017 ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka dështuar të sigurojë mbulim të balancuar të palëve të përfshira në kontekst.
7. KPM në bazë të të gjeturave nga raporti i monitorimit, me datën 24 mars 2017 i ka dërguar Njoftim për Shkelje Palës Përgjegjëse duke e njoftuar për shkeljet e bëra dhe duke e udhëzuar që në të ardhmen t’i kushtojë kujdes paralajmërimit të të ftuarve për mospërdorim të gjuhës vulgare ose ofenduese dhe të sigurojë mbulim të balancuar të palëve të përfshira në kontekst. Po ashtu, përmes Njoftimit KPM ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse të veprojë në pajtim me Kodin e Etikës KKPM -2016/03, duke i ofruar Palës Ankuese të drejtën e reagimit në afat prej shtatë (7) ditësh në pajtim me nenin 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
8. KPM me datën 29 mars 2017 përmes emailit ka pranuar nga Pala Përgjegjëse përgjigje ndaj Njoftimit për Shkelje, me pretendimin se nuk kanë pranuar ndonjë reagim nga Pala Ankuese lidhur me emisionin Rrokum Rroll të transmetuar në Rrokum TV me datë 10 shkurt 2017.
9. KPM pas përgjigjes së Palës Përgjegjëse me datën 3 prill 2017, përmes e-mailit e ka njoftuar Palën Përgjegjëse se Pala Ankueses ka deponuar në KPM dëshmi se ka dërguar kërkesën për reagim në Rrokum TV me datën 10 mars 2017. KPM ka kërkuar sërish nga Pala Përgjegjëse që Palës Ankuese t’i ofrohet e drejta e reagimit në pajtim me nenin 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
10. KPM me datën 4 prill 2017 ka pranuar një përgjigje nga Pala Përgjegjëse, në të cilën theksohet se kërkesa e Palës Ankuese nuk ka qenë e drejtë për reagim, mirëpo kërkesë për kërkim falje nga ana e televizionit.
11. Përfaqësuesit ligjor të Palës Ankuese, sërish me datë 12 maj 2017, përmes e-mailit kanë kërkuar nga Pala Përgjegjëse të drejtën e reagimit ndaj emisionit “Rrokum Roll” të televizionit Rrokum TV të transmetuar me datë 10 shkurt 2017.

Analiza Ligjore

12. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse është gjetur në shkelje të nenit 4, paragrafi 3, neni 6 paragrafi 2 si dhe nenit 10 paragrafi 1 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

13. Neni 4, paragrafi 3, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03, përcakton se:

"Në programet e drejtpërdrejta (debate/intervista, etj.), është obligim i OSHM-së që të ndërmarrë veprimet e duhura për evitimin e përdorimit të gjuhës vulgare ose ofenduese nga ana e pjesëmarrësve."

KPM, pas analizimit të emisionit ka gjetur se Pala Përgjegjëse nuk ka ndërmarrë veprimet e duhura për evitimin e përdorimit të gjuhës vulgare apo ofenduese në programet e drejtpërdrejta, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 3 i Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

14. Neni 6, paragrafi 2 i Kodit të Etikës KKPM-2016/03, përcakton se:

"OSHM-të duhet të sigurojnë një mbulim të balancuar të çështjeve me interes publik dhe çështjeve të kundërthënies politike dhe të sigurojnë një paraqitje pluralistike të pikëpamjeve, pa asnjë privilegj për ndonjë parti politike, kundërvështrim politik apo ndonjë grup ose individ."

KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka dështuar të sigurojë mbulim të balancuar të palëve të përfshira në kontekst, duke konstatuar se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 6 paragrafi 2 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

15. Neni 10, paragrafi 1 i Kodit të Etikës KKPM-2016/03, përcakton se:

"Me qëllim të korrektësisë dhe paanëshmërisë duhet të ofrohet mundësia që brenda shtatë(7) ditësh pas paraqitjes së ankesës së individit apo organizatës, të transmetoet reagimi përkatës në mediumin e njëjtë. Reagimi duhet të transmetohet në kohë dhe hapësirë të njëjtë."

16. KPM gjithashtu ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje duke mos ia ofruar të drejtën e reagimit Palës Ankuese dhe për këtë KPM ka konstatuar se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

17. Pas të gjitha fakteve të lartpërmendura KPM konstaton se Pala Përgjegjëse ka dështuar të ndërmarrë veprime të duhura për evitimin e përdorimit të gjuhës vulgare në programet e drejtpërdrejta, ka dështuar të sigurojë mbulim të balancuar të palëve të përfshira në kontekst si dhe ka bërë shkelje duke mos ia ofruar të drejtën e reagimit Palës Ankuese, dhe për këtë KPM ka konstatuar se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 4 paragrafi 3, nenit 6 paragrafi 2 si dhe nenit 10 paragrafi 1 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.


18. KPM ka gjetur se edhe përkundër Njoftimit për Shkelje dhe komunikimeve të vazhdueshme, Pala Përgjegjëse ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me nenin 10 paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, duke mos i dhënë të drejtën e reagimit Palës Ankuese.

Vendimi

19. Komisioni, bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura **kërkon** nga Pala Përgjegjëse në afat prej shtatë (7) ditësh të transmetojë reagimin e Palës Ankuese, ashtu siç përcaktohet me nenin 10, paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
20. Komisioni bazuar në nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, sanksionon me **Vërejtje** Palën Përgjegjëse për shkelje 4, paragrafi 3, nenit 6 paragrafi 2, si dhe nenit 10 paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

E drejta për Ankesë

21. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
22. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Adnan MEROVCI
Kryetar



10.08.2017

Datë